

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas akvendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-1772/1 datë 03.04.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1795/3 datë 09.04.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 14-të mbajtur më 08.04.2024, miratoi si në vijim:

Aktvendim
për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për veprimtari transmetuese SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli, sepse ka ritransmetuar shërbim programor që nuk është i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar dhe në raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-1772/1 datë 03.04.2024, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për veprimtari transmetuese SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, pra të ndërpresë me ritransmetim të shërbimit programor.

3. Të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas vendimit për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij vendimi nuk vepron sipas vendimit, gjegjësisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të rregulloreve të miratuara në bazë të tij dhe kushteve dhe detyrimeve për leje.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia me datë 02.04.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria për veprimtari radiodifuzive SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli, duke konstatuar se operatori në fjalë, i cili sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e komunës së Gjevgjelisë dhe Bogdancit, me datë 02.04.2024, për

shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, që nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Gjetjet nga mbikëqyrja janë të specifikuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-1772/1 datë 03.04.2024, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-1772/1 datë 03.04.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1795/3 datë 09.04.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave nga LSHMAAV, cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin ndaj subjektit të lartpërmendur shqiptohet masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë që pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhërit, pra sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë ritransmetimin e shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-1772/1 datë 03.04.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.